



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:169943

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06893865

**C.nr.335/2022**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Nehat Qelaj në çështjen juridike të paditëseve S.M.nga fshati G., Komuna e Malishevës, A.M.nga fshati G., Komuna e Malishevës dhe A.M.nga fshati G., Komuna Malishevës të cilët i përfaqëson avokat Agron Kryeziu nga Malisheva, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, për dëmshpërblim, jashtë shqyrtimit kryesor me datë 24.02.2025, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**Konstatohet se është Tërhequr** padia e paditëseve S.M.nga fshati G., Komuna e Malishevës, A.M.nga fshati G., Komuna e Malishevës dhe A.M.nga fshati G., Komuna Malishevës, e ushtruar me datë 27.05.2022 kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, për dëmshpërblim.

**A r s y e t i m**

Paditësit e lartpërmendur me datë 27.05.2022 në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tyre Agron Kryeziu avokat nga Malisheva, ka parashtruar padinë ndaj të paditurës si më lartë për dëmshpërblim.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me datë 05.10.2022 e njoftoj të paditurën me aktvendim për përgjigje në padi. Pas pranimit të këtij aktvendimi e paditura me përgjigje në padi ndër tjera ka deklaruar se pasi që kemi pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, padinë dhe shkresat tjera të lëndës, në bazë të cilave kërkesëpadinë e paditësve nuk e kontestojmë për sa i përket ndodhjes së aksidentit dhe shkaktimit të tij nga ana e të siguarit tonë por e kontestojmë për nga lartësia e tij. Bazuar në dokumentacionin mjekësor të cilat paditësit e kanë bashkangjitur me padi, mendimin e mjekut cenzor të kompanisë të bazuar në këto dokumentacion, rezulton se paditësja S.M.në aksidentin e datës 05.05.2022 ka pësuar lëndime të lehta trupore, A.M. në aksidentin e datës 05.05.2022 ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe A.M.në aksidentin e datës 05.05.2022 ka pësuar lëndime të lehta trupore.

Bazuar në këto kualifikim të dëmit, Rregulloren për Trajtimin e dëmeve materiale dhe jo materiale të miratuar nga BQK-ja dhe Ministria e Shëndetësisë e paditura ka trajtuar kërkesat paditësve për dëmshpërblim brenda afateve ligjore dhe paditëses S.M.i ka ofruar shumën për marrëveshje 530 euro, paditëses A.M.shumën prej 534.00 euro dhe për A.M.shumë prej 460.00 euro duke konsideruar që këto shuma janë një satifaksion i mjaftueshëm për palët paditësit konform lëndimeve të pësuar.

I autorizuari i paditëseve këtu av. Agron Kryeziu, me datë 19.07.2024, në gjykatë deponon parashtresën mbi tërheqjen e padisë duke njoftuar gjykatën se paditësit me të paditurën kanë arritur që këtë çështje për kompensim të dëmit material dhe jo material ta mbyllin me marrëveshje jashtëgjyqësore. Pasi që paditësi me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, paditësit e tërheqë padinë për lëndën C.nr.355/22, pasi që paditësit tani e kanë realizuar kërkesën për dëmshpërblim.

Meqenëse e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, gjykata një kopje të parashtresës për tërheqjen e padisë ja ka dërguar të paditurës me qëllim të deklarimit për tërheqjen e padisë. E paditura nuk është deklaruar brenda afatit 7 ditësh nga dita e pranimi të njoftimit me datë 14.08.2024, andaj meqenëse e paditura në afatin e lart cituar nuk është deklaruar për tërheqjen e padisë, në kuptim të nenin 261.2 të LPK-së konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin.

Bazuar nga të lartcekurat Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 261 të Ligjit Procedurës Kontestimore.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë,  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil  
C.nr.335/22 datë 24.02.2025.**

**G j y q t a r i**  
Nehat Qelaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës.